

Përshëndetje,

Lutem gjeni ne vijim pergjigjen, lidhur me kerkesen tuaj:

Pajisjet mjekësore, pjesë e të cilave janë edhe fishat e diabetit, janë pjesë e skemës së rimbursimit nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nga viti 2018.

Lista aktuale e pajisjeve mjekësore të rimbursuara është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 229 datë 13.04.2022. Në bazë të këtij vendimi, fishat e diabetit rimbursohen për dy grupe pacientësh: fëmijë 1-18 vjeç dhe studentë 18-25 vjeç.

Zgjerimi i skemës së rimbursimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, përfshirë fishat e diabetit për pensionistët, mbetet prioritet i punës së FSDKSH dhe do jetë subjekt i vlerësimit të komisioneve teknike.

Në lidhje me kategorinë e pensionistëve, është prioritet trajtimi i sëmundjeve kronike nëpërmjet terapive të përcaktuara në Listën e Barnave të Rimbursueshme, ku trajtimi për sëmundjet diabetike është i plotë dhe ofrohet falas për të gjithë.